



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.297/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 04.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.297/2025, e datës 01.02.2025, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 01.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon më datë 31 janar 2025, në ora 00:47/h, mbështetësi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, z. Arsim Zymberi, ka publikuar një video në profilin e tij në rrjetin social Facebook, në të cilën video shihet një foto me mbishkrimin : "*Kta djemtë e Radojqiut e kanë ni siklet te madh qe pi japin kaq shume zor mos me fitu Albini. Kta kanë me met me gishta ngoj kur ti konfiskohet pasuria edhe kur të shkojnë në qorrrk.*" ku përveç tjerash, ka edituar fotografinë, duke i vendosur disa kapele të xhandarmërisë serbe dhe gjithashtu videos i ka bashkëngjitur edhe këngë në gjuhën serbe, gjuhë kjo e cila përbën nxitje të përçarjes, urrejtjes, dhunës dhe përçmimit ndaj anëtarëve si dhe subjektit të Partisë Demokratike të Kosovës. PDK vlerëson se në veprimet e z. Arsim Zymberi janë konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar, të përcaktuar në nenin 34, par. 1, nën paragrafi 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. PDK e vlerëson si të rëndësishme të theksoj faktin se ndonëse personi i cili ka shpërndarë videon me tekstin shoqërues si në prezantimin e fakteve të rastit është mbështetës i Lëvizjes Vetëvendosje, në rrethanat e rastit konkret, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në nenin 2, par. 2, nën paragrafi 2.6, ka përcaktuar se ky ligj rregullon "*Zhvillimin e fushatës zgjedhore, rregullat e mirësjelljes së subjekteve Politike, kandidatëve të tyre dhe mbështetësve si dhe kufizimet e shpenzimeve të fushatës*". Andaj, në rrethanat e rastit konkret, përgjegjësinë për veprimet eventuale të mbështetësve e mban subjekti

politik, në këtë rast Lëvizja Vetëvendosje. Për qëllime të argumentimit të afatshmërisë së ankesës, PDK, njoftoj PZAP se shpërndarja e fotografisë në rrjetin social Facebook nga z. Arsim Zymber është bërë më 31 janar 2025, në ora 00:47/h dhe se postimi vazhdon të jetë ende aktiv në profilin e të njëjtit. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë: Postimin e publikuar në profilin e z. Arsim Zymberi, mbështetës i Lëvizjes Vetëvendosje, në rrjetin social Facebook: <https://www.facebook.com/reel/1125167065539118> dhe Screenshoot nga postimi i z. Arsim Zymberi, në të cilën dëshmohet data dhe koha e publikimit të postimit me tekst shoqërues, e cila përmban gjuhë të urrejtjes dhe nxitjes.

Në përgjigjen në ankese Anr.297/2025, të datës 03.02.2025, theksohet se kundërshtojmë në tërësi legjitimitetin pasiv që të përgjigjemi lidhur me pretendimet për persona fizik të cilët hapin llogari në facebook pa verifikim të personalitetit paraprakisht, me çka profilin me emrin z. Arsim Zymberi e kontestojmë për vërtetësinë e tij, pasi që ky profil nuk përmban asnjë informacion individual për ndonjë person konkret e aq më pak se ky person është mbështetës i LVV-së. Informacioni që i njëjti ka shpërndarë flasin për vende pune fiktive në botën e jashtme ku nuk mund të vërtetohet identiteti i tij. Nga të dhënat që kemi si parti politike, nuk kemi asnjë dëshmi se i njëjti është apo ka qenë ndonjëherë përkrahës i partisë tonë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruara si provë materiale, dhe vlerësimit të përgjigjes në ankese ka gjetur se shprehjet e përdorura në rrjetin social Facebook nga personi me emrin Arsim Zymberi, nuk mund të vërtetohet se i njëjti është kandidat apo mbështetës i subjektit politikë LVV.


Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankese dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetojë se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura ligjore, dhe si të tilla këto pretendime i refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 297/2025 më datë 04.02.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.